

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. ENKELEDI HAJRO

06/10/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 05.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 10.06.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Enkeledi Hajro, kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Olsi Komici, z. Roland Ilia relator, znj. Valbona Sanxhaktari anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.